

## PORTRETI KRIJUES I QOSJES NËN NJË VËSHTRIM SOCIOLOGJIK DHE ZHANROR

Leonora HAJRA

Letërsia parimisht e ka bazën në krijimet orale të shoqërive të para primitive, dhe vetë përcjellja e saj është produkt i një zinxhiri kolektiv, pra ajo është krijuar dhe rrjedh shkrirë me kujtesën njerëzore si tërësi, dhe edhe atëherë kur krijohet nga individ i mban në vete tërësi arketipesh të krijuara nga një vetëdije e përbashkët kolektive, e aftë të gjenerojë vazhdimisht struktura të reja polisemike. Krahas këtij raporti që duket se rrjedh natyrshëm dhe çiltër, është edhe raporti tjetër midis letërsisë dhe shoqërisë, që lidhet direkt me sistemet totalitare aq analoge sado që të shfaqura në periudha të ndryshme të historisë.

Ashtu sikurse në letërsinë botërore, edhe në letërsinë shqipe, duket sikur veprat letrare kanë prekur kulmin e realizimit artistik pikërisht në përpjekjen për prezantimin e vendit të individit, natyrës, servilizmit o desidencës së tij brenda kronotopos it despotik. Me shfaqjen e Qosjes në vitet e 70-ta nis periudha e kolosëve të letërsisë shqipe. Vepra e tij luan një rol të dyfishtë, meqë në radhë të parë me temën, prezantimin e realitetit të individit të ndrydhur brenda sistemit jep një tablo universale edhe të ballafaqimit të letërsisë me represivitetin e ambientit dhe në radhë të dytë meqë me strukturën e ndërtimit të veprës së tij letrare bëhet iniciator i poetikës postmoderne në romanin shqiptar. Poetika postmoderne që integron Qosja në letërsinë shqipe, është periudhë aktive në letërsinë evropiane, për dallim prej rrymave të tjera letrare, të cilat te ne janë zhvilluar zakonisht pasi janë shuar te të tjerët, prandaj edhe fare mirë mund të pohohet se falë tij letërsia shqipe për herë të parë zhvillohet në koherencë me ritmin e rrymave letrare evropiane.

### 1. Letërsia dhe shoqëria

Fytyra e individit disident brenda sistemit totalitar jugosllav, vetë shoqërisë brenda sistemeve hipokrite që duke u përpjekur të jenë demokratike shpërfytyrojnë natyrën e lirë që ofron ky rregullim socio-politik dhe kujtesa mitike e historike përbëjnë themelet mbi të cilat ndërtohen tri veprat e Qosjes: *Një dashuri dhe shtatë faje, I ringjalluri i penduar dhe Beselam, pse më flijojnë?*.

Arkitektonika socio-politike përbën skemën bosht që lidh të tri veprat, sado që realizimi i saj nuk ruan strukturën analoge nga vepra në vepër, ku vazhdimisht këmbehen individ, shoqëria dhe sistemi në raporte të ndryshme. Lexuesi përballet me gjithë fytyrat e njeriut si: servilizmi, refuzimi, kundërvënia, dashuria, nënshtrimi, altruizmi, hipokrizia, e që në thelb secila prej tyre shfaq intencën e njeriut për të mbijetuar, sado që rrugët e zgjedhura për të janë të ndryshme, pasi që në asnjë rast nuk barazohen servilizmi, detyrimi dhe refuzimi. Brenda triadës individ-shoqëri-sistem secili prej aktantëve luan një rol të veçantë duke u shkëmbyer në raporte kryesisht të rendit sintagmatik.

Në strukturën e tri veprave është e centralizuar vetëdija shoqërore shqiptare e modeluar në tri kaptina të veçanta të historisë: shekulli XV, periudha e shtrimit të pushtetit osman brenda Ballkanit, viti 1981, periudha e demonstratave të studentëve të Universitetit të Prishtinës dhe e diferencimit politik jugosllav si reaksion ndaj tyre, si dhe periudha e pasluftës, përpjekjet e para të konstruktimit të rregullit shoqëror demokratik.

Drama, *Beselam, pse me flijojnë?* shpalos uzurpimin e popullit nga një idelogji e re e cila bie në kundërshtim me të vjetrën, totalitetin e sistemit në raport me individin dhe simbolikën e idealit të dështuar e cila këtu merr fytyrën e individit që në përpjekje të përmbushjes së idealit sakrifikon vetë gruan e tij, duke u bërë kështu viktimë e sistemit që zgjedh të bëjë lojë të dyfishtë. Haruni, Harani, Ixhlili si përfaqësues të sistemit dhe Molosi, Monuni, Beselami, Laidi e Bidadi si përfaqësues të dëshiravë të masës, përbëjnë dy boshtet prej nga reflekton politika e uzurpimit të brendshëm, shtrëngimit të pranimit të besimit monoteist që proklamoi sistemi. Përzgjedhja e një kohe të largët, politikës së Perandorisë osmane të shek. XV gërshetuar gjithashtu me mitet e flijimit përbën kronotoposin që i mundëson autorit të vizatojë portretin permanent të sistemit totalitar, që ndër shekuj ka zbatuar të njëjtat metoda të dhunës, imponimit e censurimit të lirisë së njeriut.

Në qendër është një popull, dëshira e tij për të ndërtuar një urë, që synon të jetë e dobishme për popullin, pasi shihet si lidhje me pjesën tjetër të botës, e që dhënë në mënyrë implicite mund të kuptohet si rruga e emancipimit e përparimit, e mira që synohet dëshira tashmë e shqiptarit për t'u lidhur e gjëlluar me frymën perëndimore, dhe në anën tjetër shtrëngimin e sistemit që në sy të popullit detyrohet ta përkrahë ndërtimin e urës, ndërsa fshehurazi, punon për dështimin e këtij ideali. Haruni, që del një prijës i shtetit, madje mundohet që ta bindë popullin që të heq dorë nga ndërtimi i urës, për të ndërtuar një kështjellë, këtu del edhe një argument tjetër që mbron edhe njëherë pohimin e mësipërm mbi përpjekjet e sistemit që ta shtrëngojë e ngulfat popullin brenda një hapësire të izoluar ku do ta ketë nën kontroll ku edhe domosdo populli do t'ia ketë nevojën. Insistimi i popullit për ndërtimin e urës dëshmon për kapërthimin e tij pas idealit të çlirimit jo vetëm hapësinor në nivel fizik por edhe psikik, pra zgjerimit të pikëpamjeve të tij mbi pjesën tjetër të botës e më tutje mbi vetë jetën si modus më i gjerë.

Si e realizon politikën e tij sistemi? Sistemi këtu funksionon i kamufluar nën petkun e utilitarizmit. Pra, në një njërën anë proklamohet që punon dhe ia do të mirën popullit, prandaj edhe shpaloset si përkrahës i ndërtimit të urës në fjalimet e Harunit, ndërsa në anën tjetër është ai që rrënon natën urën-atë çka ustallarët kanë punuar ditën e me këtë edhe synon që t'i bindë ustallarët si masë e popullit se vetëm duke iu lutur Zotit të tij do t'ia arrijnë t'i ndalin këto rrëtime.

Harani i kamufluar si Iblis dhe improvizimi me hijen e brinjat e dhisë që enden përgjatë urës si shenjë e nevojës së sakrifikimit të një qenieje në themelet e saj janë dy linjat boshtore që realizojnë idenë sublime të veprës. Iblisi është ai që bëhet fitil i lëkundjes së idealit të ndërtimit të urës, ndërsa zhdukja e tij pasi Ixhlili thotë fjalët e shenjta, ka qëllim të tërheqë masën në besim duke treguar fuqinë e fjalëve të shenjta mbi të cilat vepron kjo fe, pra vërtetësinë e asaj që mbron e proklamoi sistemi.

*Ixhlili: "Mjerë ai që shtien dhe përqesh, se ai do të jetë i hedhur në Hutamë."*

*(Ikën Iblisi)*<sup>1</sup>

Linja e dytë që lidhet me sakrifikimin është rimarrje e baladës së Rozafatit, përgjithësisht mitit të flijimit që qarkullon në oralitetin ballkanas. Kështu sakrifica e Hanës dhe pyetja Beselam pse më flijojnë? aq e thjeshtë në vetë, por aq e thellë orientojnë në një çmitizim tjetër të Qosjes, pra *flijimi është i pafuqishëm, naiv, i cili nga brenda ndiqet nga përqeshja cinike e shëmtimit-pikërisht për kotësinë e vet.*<sup>2</sup> Me sakrificën spikatet ngadhënjimi i sistemit për dy arsye. Fillimisht duke treguar pavlefshmërinë e sakrificës autori sikur prezanton edhe njëherë infantilitetin e popullit i cili idealet e tij i mbështet në besëtytni, që këtu del një dërrasë e kalbur në të cilën shkel populli, ndërsa në rastin e dytë paraqet mendjemprehtësinë e sistemit që njeh e shfrytëzon dobësitë e popullit të tij, naivitetin, me rrënimin e urës edhe pas sakrificës populli automatikisht përqafon besimin e ri/ njëshin komunist.

<sup>1</sup> Rexhep Qosja, *Mite të zhveshura*, Instituti Albanologjik, Prishtinë, 2010, fq.220.

<sup>2</sup> Ali Aliu, *Kritika*, Rilindja, Prishtinë, 1980, fq.114.

Universalisht paraqitet njeriu i cili nuk tregohet largpamës rrezikun që ka pranë nuk e ndjen duke vështuar larg në të kaluarën, nga del edhe ideja autoriale se nuk mund të kërkohej përparim për sa kohë nuk është kaluar ajo çka i takon fazës së një psike më konservative më të ngjeshur me natyrën.

*I ringjalluri i penduar*, nga ana tjetër, është një ndër tregimet më interesante satirike të shkruara ndonjëherë në letërsinë shqipe. Sintagma e veçantë që ndërton autori, një i ringjallur i penduar, e që duket sikur në thelb e përbuz vetë gjakimin e njeriut për eternitetin, bëhet indicie parësore e leximit të tekstit. Këtu i ringjalluri është Skënderbeu. Figura historike aq herë e mitizuar brenda letërsisë shqipe, në periudhën e ekzistimit të saj në një largësi prej pesë shekujsh vjen këtë radhë si një demaskuese e sistemit që parimisht ofrohet si demokratik, por në rrugë e sipër del si destruktiv dhe vetëironizues i parullës *barazi e liri*.

Vepra ka për kronotopos Kosovën e pasluftës dhe sistemin manipulues demokratik, që shfrytëzon naivitetin e shoqërisë dhe rrjedhimisht vjen e fuqizohet përmes demagogjisë dhe nepotizmit. Vetë inkudrimi i Skënderbeut, udhëtimit të tij për ta njohur sistemin mbi të cilin kanë ndërtuar jetesën “nipërit e tij”, përkujton *Udhëtimet e Guliverit*, satirizimit që kjo vepër i bën puritanizmit, nepotizmit, matrapazllëkut e represivitetit politik. Natyrisht ndryshon qasja. Për dallim prej Guliverit ku gjithë udhëtimet e personazhet e tij i takojnë botës së përrallave, tregimi i Qosjes, ka fantastike vetëm ringjalljen e Skënderbeut dhe gjithçka tjetër ndodh në rrafshin real dhe efekti përqeshës realizohet pikërisht në këtë disproporcion që ndërton figura e Skënderbeut me kohën në të cilën është kthyer. Këtu *satirë përbëjnë: teksti, politikanët, e përditëshmja, e zakonshmja, ndërsa parodi: preteksti, heroi, e rralla, e jashtëzakonshmja*<sup>3</sup>.

Habia e tij, e qeshura e kureshtja bëhen mjete çelës që çmontojnë fytyrën e sistemit despotik që me këmbëngulje në përmasa groteske pohon: *partia jonë është për demokraci, liri e pavarësi, larmadhëri! Ha, ha, ha!*<sup>4</sup> Qysh në kapitullin e parë, me insistimin e Gojë Burrelit, Muhamed Turjelës e Zef Mardinit, për ringjalljen e Skënderbeut me qëllim të manipulimit të popullit gjatë zgjedhjeve, autori ironizon indirekt me fushatat masive politike, që shfrytëzojnë çdo mjet të mundshëm për të përfituar, mashtruar popullin (makiavelizmi).

E pamundshmja këtu shërben për të treguar fanatizmin e partive politike. Kështu udhëtimi i Skënderbeut, diskutimet për mazën, tambëlin, borën, dardhat e ardhura, bizonët, uraniumin e qentë “e fabrikuar” dhe përfitimet marramendëse që premtojnë politikaneët të arrijnë me tregtimin e tyre shpalosin pikat kyçe të këtyre fushatave që shembëllojnë absurditetin, të pamundurën- iluzionin e emancipimit shoqëror e ekonomik me *shpejtësinë e dritës së diellit*. Ironikisht jepet figura e popullit që hipnotizohet e duartroket këta demagogë, që imiton mekanikisht lëvizjet e të parit të qytetit dhe konstatimi me ngjyrim sarkastik i Skënderbeut: *popull i dëgjueshëm*.

Fjalimet e politikanëve, përbëjnë pjesën tjetër ku ravijëzohet pseudointelektuali. Në këtë pikë në plan të parë vihet thumbimi i politikanit narcist, skajshmërisht i vetëkënaqur e megaloman që lexon mekanikisht fjalimet e bëra nga tjetri, por mban qëndrimin e njeriut që ia ka kaluar oratorisë së vetë figurave intelektuale të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit.

Kapitulli i fundit, spikat me një ngjyrim të veçantë realitetin e pasluftës, shfaqjen dhe shkëlqimin e papritur të figurave politike, të dhëna pas dëshirës për të zënë vendin brenda pushtetit atëbotë të centralizuar, masën naëve që me përkrahjen e iluzioneve të politikanëve që marrin përmasa të zbulimit të jetës në Mars bëhet shtysë e fuqizimit të pushtetit brenda jetës së tyre si dhe më gjerë bën fjalë edhe për harrimin e rolit të sakrificës së heronjve në çlirimin e vendit, për çka edhe Skënderbeu përfundon: *Ata djem që ua sollën lirinë këtu nuk i dëgjova! Ku janë si do të më duan mua ata që s'i duan çlirimtarët e vet?*<sup>5</sup>

<sup>3</sup> Ag Apolloni, *Parabola postmoderne*, Bardbooks, Prishtinë, 2019, fq.321.

<sup>4</sup> Rexhep Qosja, *I ringjalluri i penduar*, Instituti Albanologjik, Prishtinë, 2010, fq.314.

<sup>5</sup> Po aty, fq.361.

Vepra tjetër e Qosjes *Një dashuri dhe shtatë faje*, është roman që insiston në imitimin e fakteve.<sup>6</sup> Ai prezantohet si një dorëshkrim i kujtimeve të Çerem Çaparit, individit kontravers të persekutuar dhe detyrimisht të vetëinternuar në Amerikë. Forma e realizimit, tema që ndërthur mes vete historinë dhe fiksionin në një raport postmodern, jo si përfaqim, por refuzim, ironizim të një të kaluarë, pra historia si një ripërpunim kritik dhe asnjëherë “kthim nostalgjik”,<sup>7</sup> dëshmojnë për prezencën e metafikcionit historiografik.

Vepra del si një përmbledhje e kujtimeve të tij në të cilat ai çuditërisht, më parë se protagonist është narrator dëshmitar, pra narrator i ndodhive të të tjerëve, i Mihran Kumanit, Man Kurtit, Rozaf Gashit, Hana Ujëmiri e Kush Akxhiut. Secili prej personazheve shpalos realitetin tragjik të njeriut të ndrydhur si identitet brenda despotizmit jugosllav. Përkundër pluralizmit popullativ brenda kësaj mbretërie, vihet theksi në monizmin represiv serb favoret e saja karshi disfavoreve të shqiptarëve të përbuzur e të nënçmuar brenda kësaj shoqërie.

Tregimi i parë, ose kapitulli i parë i romanit për dallim prej tetë tregimeve të tjera, që kanë për bosht kryesor demonstratat e 11 marsit, bën fjalë për vitin 1948, dhe fokusohet në dhënien e tablos së një shoqërie infantile, naëve, është pikërisht periudha kur nxjerrin krye figurat e para servile të sistemit dhe në raport me to vihet spikama në pavetëdijen e shoqërisë për ndryshimet rrënjësore në dëm të lirisë e vetë harmonisë së saj.

Modelimi i këtyre tri veprave të Qosjes brenda strukturave të ngjeshura ideosemantike, ka bërë që interpretimet për to të variojnë nga universalja, vështrimi i ngjarjeve të rrëfyera si ndeshje të forcave dualiste, tek konkretja, vështrimi i tyre në raport me historikun e popullit shqiptar brenda strukturave totalitare pushtuese. Nga të dy konstatimet del se ajo çka është analoge dhe e pamohueshme në romanin *Një dashuri dhe shtatë faje*, dramën *Beselam pse më flijojnë* dhe satirën *I ringjalluri i penduar* është kundërvënja ideologjike midis personazheve, të cilat ndërtohen si antipode të njëri-tjetrit. Konfrontimi i tyre do parë në dy nivele: si ndeshje midis individit refuzues dhe ideologjisë së diferencimit politik (ideolog-disident) dhe si ndeshje midis politikës manipuluese e shoqërisë (demagogë-popull).

I. Konfrontimi ideolog-disident: Në romanin *Një dashuri dhe shtatë faje*, me Çerem Çaparin internohet figura puro e disidentit, individit si përfaqësues i pikëpamjeve liberale që duhet të konstruktojnë jetën e njeriut. Kundërvënja e tij ndaj instalimit të sistemit në dëm të psikës e fizikes së qenies që radikalisht mohon diferencimin e puritanizmin e strukturës totalitare jugosllave, në vepër del si insistim i individit për identitet, diçka parimisht e mohuar brenda kësaj strukture. Kjo del më së miri në përgjigjen që i jep pyetjes së botuesit, Arben Begesë, mbi arsyen e largimit të tij nga Vajazani: *nuk kam mundur të pajtohem me poshtërimin e vetvetes si kusht për të qenë aty ku isha; nuk kam mundur ta dënoj sot atë që nesër do të mbrohet prej të gjithëve; nuk kam mundur ta quaj të drejtë të padrejtën e ta quaj të padrejtë të drejtën...*<sup>8</sup>

II. Konfrontimi demagogë-popull: Për dallim prej sistemit totalitar që kur rrezikohet nuk bën kompromis fare me masën, pra ruan konstant fytyrën monstruoze të tij para atyre që i kundërvihen idesë së bashkim-vëllazërimit, brenda dramës dhe satirës së Qosjes, shfaqet fytyra tjetër e sistemit, në fakt *dyfytyrësia*/hipokrizia e tij. Këtu centralizohet sistemi që bën kompromis në sy të popullit, bën demagogji, ndërsa prapa syve të tij rrënon idealet e popullit dhe punon në dobi të fuqizimit të pushtetit të tij vetjak. Drama *Beselam, pse më flijojnë? reagon ndaj politikës, pasi inspekton qëllimet e saj*.<sup>9</sup> Prezantimi i dy besimeve të ndryshme, politeizmit dhe monoteizmit, është në thelb konfrontim i ideologjive, që lidhen me psikën konservatore të popullit dhe idealit të njëshit që proklamon sistemi.

*Ixhlili: Një gjë s’e ke të qartë: çdo kohë ka lutjen e vet, siç i ka çdo stinë bimët dhe muajt e vet. Beselami: Mos do të thuash ndryshe se çdo kohë e ka perëndinë e vet.*<sup>10</sup>

<sup>6</sup> Ag Apolloni: Vepra e cituar, fq.106.

<sup>7</sup> Linda Hutcheon, *Poetika e postmodernizmit*, Om, Prishtinë, 2013, fq.19.

<sup>8</sup> Rexhep Qosja, *I ringjalluri i penduar*, Instituti Albanologjik, Prishtinë, 2010, fq.9.

<sup>9</sup> Armagedoni, *Dramat e Qosjes*, Armagedoni, Prishtinë, 2019, fq.118.

<sup>10</sup> Rexhep Qosja, *Mite të zhveshura*, Instituti Albanologjik, Prishtinë, 2010, fq.217.

Ky synim për ndryshimin e lutjeve, bëhet prioritet për sistemin e Harunit dhe për këtë ka rëndësi ky ndryshim i lutjeve, sepse me këtë sistemi e bën aplikimin e ideologjisë së Njëshit, ideologjinë e tij te njerëzit.<sup>11</sup> Mes tjerash, implicisht insistimi i vazhdueshëm i Ixhlilit që masa të mendojë si ai shtron hapur edhe çështjen e humbjes së autencitetit të individit brenda sistemit totalitar përmes idealit të sistemit të bashkim-vallëzërimit, që megjithatë kurrë nuk mund të jetësohet sepse nuk mund të ketë tërësi pa individualitet.<sup>12</sup> Fjalimet e Harunit, lutja e Ixhlilit, kërkesa e sakrificës, insistimi invers i Haranit që ura të bëhet kështjellë përbëjnë pikat konektive në të cilat mbështetet sistemi në drejtim të mbajtjes së kontrollit të pushtetit dhe përhapjes së ideologjisë.

Prania e profetit, si person që paralajmëron diçka që do të ndodhë në të ardhmen, është element i hershëm në letërsinë botërore dhe për këtë mjafton një vështrim nga veprat antike me orakujt e Apollonit, të cilët parathinin fatin e njeriut dhe përçonin pamundësinë e tij për t'iu kundërvënë këtij fati, duke e prezantuar si diçka të paracaktuar që qëndron përtej fuqive të tij. Në veprën e Qosjes kjo figurë shfaqet në tri pozicione të ndryshme: si parathënës i kataklizmatëve socio-politikë gjatë vitit 1981 (*Një dashuri dhe shtatë faje*), si urë lidhëse midis së tashmes dhe së ardhmes, si njohës i së kaluarës dhe lexues i botës si sistem shenjash gjë që do ta orientojë masën drejt arketipit të flijimit (*Beselam, pse më flijojnë*), dhe si orientues drejt të vërtetës së realitetit që me këmbëngulje përpiqen ta fshehin demagogët politikë (*I ringjalluri i penduar*).

## 2. Parabolat intertekstuale

Intertekstualiteti, si dukuri e komunikimit të tekstit vetjak të autorit me tekstet e tjera përbën një ndër celulat kryesore në ndërtimin e veprave postmoderne e rrjedhimisht një faktor që përligj atributimin e tillë që i bëhet romanit *Një dashuri dhe shtatë faje*. Ky roman i Qosjes është i stërmëbushur me citime biblike, kuranore, filozofike e shkencë, shpeshherë të dhëna direkt ose të transformuara, por gjithmonë në shërbim të përcimit makroideor të autorit-zhvishjen totale të metanarrativave.

Ajo çka qëndron si linjë opozicionale ndaj sistemit totalitar të reflektuar brenda veprës është insertimi i zërit të Monteskses, përfaqësues i frymës demokratike, një antipod dhe kritikues fundamental i frymës komuniste. Romani *Një dashuri dhe shtatë faje* përbëhet nga shtojcat e ashtuquajtura “Nga fletorja e shënimeve”, të cilat shërbejnë si pika konektive midis kapitujve. Në shtojcën e tillë të parë, autori inkudron një tekst të shkurtër nga vepra e Monteskses “Mbi frymën e ligjeve”, në të cilën spikaten kontemplacione që kategorikisht ndëshkojnë modalitetet mbi të cilat funksionon komunizmi. Montesksja kritikon pezmin, servilitetin e zvetënimin e personalitetit të individit brenda një sistemi destruktiv absolut:

*Te popujt, të cilët kanë mbetur pas në zhvillim, si dhe te popujt që jetojnë në despoti, ku fati e favorizon jashtëzakonisht vetëm një njeri, kurse krejt popullsia tjetër i nënshtrohet dhunës dhe nëpërkëmbet, gjithçka bëhet në mënyrë mizore...ajo që duhet të na dallojë prej popujve barbarë, është qytetaria e zakoneve dhe e ligjeve dhe jo mënyrat e sjelljes së shtirë e lajkatare.*<sup>13</sup>

Në këto citime, Montesksja midis tjerash flet për një kohë kur të madhit i putheshin këmbët (*kohë e mashtrimit*), pra për një kohë që do t'i bëjë pasardhësit të skuqen.<sup>14</sup> Montesksja shfaqet si figurë pacifiste, kundër njerëzve të cilët dhunojnë lirinë e privatësinë e tjetrit e madje bëhen shkaktarë të përfundimit tragjik të tij brenda pushtetit që me fanatizëm kërkon respektimin e normave që përcakton. Ai diskuton edhe mbi frikën e sistemit nga shkrimtari disident, vepra e tij si demaskuese e së vërtetës, e tiranisë që realizohet nën flamurin e bashkim-vëllazërimit. Simpatia e Qosjes për Montesksjen shfaqet edhe si pikë konektive midis veprave të tij, çka ruan

<sup>11</sup> Adil Olluri, *Miti i zhveshur*, në librin *Krijimtaria shkencore dhe letrare e Rexhep Qosjes*, Instituti Albanologjik, Prishtinë, 2007, fq.330.

<sup>12</sup> Resmije Kryeziu, “Fjalori në strukturën e romanit *Një dashuri dhe shtatë faje*” në librin *Krijimtaria shkencore dhe letrare e Rexhep Qosjes*, Instituti Albanologjik, Prishtinë, 2007, fq.164.

<sup>13</sup> Rexhep Qosja, *Një dashuri dhe shtatë faje*, Instituti Albanologjik, Prishtinë, 2010, fq.13.

<sup>14</sup> Adil Olluri, *Romani postmodern shqiptar*, Uet Press, Tiranë, 2015, fq.42.

linearitetin e filozofisë së Qosjes, dëshirën për çlirim nga tjetri. Ky gërshetim filozofik nxjerr krye, në një dialog të Habilit me Undinën, te drama *Sfinga e gjallë*:

*Habili: Vdekja është fund i natyrshëm i jetës, kurse vrasja është dhunim i jetës. Kur ta shkurtojnë jetën me pushkë, është më lehtë se kur ta shkurtojnë ndryshe. Vrasja ka njëmijë mënyra e vdekje vetëm një. ...Të hanë shpirtin duke të ngritur dhe zbritur, si të ishe flamur i leckosur, si të ishe në një kambanë të madhe, së cilës i bie dikush me çekan përjashta: kur pushon ai ti vjen në vete, kur ia fillon rishtazi, ti prapë humb veten. Në fund s'dihet do të jesh i vdekur apo do të jesh i çmendur. Shpirti i njeriut- gjellë e dorasit! Çfarë gjelle e shijshme! E ke provuar?*<sup>15</sup>

Kjo pjesë shenjon gjithë tematikën e Qosjes brenda veprave të tij me individin e persekutuar, vështirimin e tjetrit si ferr, totalitetin që përbuz individualitetin, akuzimin e shpifjet e pavenda nga hafijet, servilët e sistemit, vdekjen shpirtërore që vjen nga ngushtimi i hapësirës së gjëllimit të vullnetit të individit, pasigurinë nga rrethi, frikën e tëhuajësimit nga vetja e ambientit, konsumimi i shpirtit të individit, zvetërimi i idealeve të tij del si krimi më masiv i sistemit totalitar. Këtë e dëshmojnë më së miri figura e Çerem Çaparit, Man Kurtit e Rozaf Gashit. Secili prej tyre etiketohet nga sistemi pasi mendon ndryshe, kundërshton absurdin e njësimi dhe metodat tiranike të autoriteteve sunduese; secili prej tyre detyrimisht i ofron vetes zgjidhje duke sakrifikuar pjesën më të vlefshme nga qenia e tij, identitetin, për çka edhe mban një qëndrim konstituent kritik Monteskje.

Maksima e famshme e Makiavelit qëllimi arsyeton mjetin, aq shpesh e përdorur si ideostrukturim brenda veprave letrare, gjen zbatim funksional në dramën *Beselam, pse më flijojnë* të Rexhep Qosjes. Harani, personazh ideoproklamues i sistemit, me maskimin si Iblisi (djalli), përdorimin e metodave sadiste, mbrojtjen me fanatizëm të sistemit si identitet totalitar mbi individin dhe shoqërinë bëhet instalues i kësaj ideologjie.

Praktikimi i makiavelizmit, këtu si filozofi që kontrollon natyrën e veprimit të njeriut në shërbim

të përmbushjes së idealeve, del si dhunim i identitetit autentik të individit. E realisht në themel të

gjithë veprës së Qosjes qëndron kjo përballje midis sistemit jokompromentues me interesat e masës, dhe individit i cili bëhet viktimë e këtij puritanizmi.

Ideja e Haranit se njeriu bindet e e përqafton të vërtetën e imponuar me dhunë, ndërton një paralele me Rabinin e Nolit te drama *Israilitë e filistinë*. Ngjashëm si Harani, Rabini kundërshton dërgimin e Samsonit, ashtu vetëm për udhëzimin e popullit filistinë, sepse sipas tij pushteti vjen nga fuqia, kjo vlen edhe për të vërtetën, prandaj kërkon që ajo t'u imponohet me dhunë filistinëve.

Molosi dhe Monuni janë viktimat e Haranit, këta sado që insistues në ndërtimin e urës kundërshtohen e akuzohen absurdisht nga Harani, vetë rrënuesi i urës, duke dashur kështu t'i orientojë drejt pranimit të besimit, idesë së njëshiti që unifikon në fund sistemi. Provokimi i tij ndeshet me kokëfortësinë, stabilitetin e tyre në idenë e tejkallimit të ambientit të izoluar identifikuar me kështjellën. Përfundimi i tyre tragjik dëshmon edhe njëherë për totalitetin e sistemit, i cili nuk kursen viktimat në drejtim të ruajtjes së stabilitetit e imponimit të idesë së njëshiti, "barazisë".

<sup>15</sup> Rexhep Qosja, *Mite të zhveshura*, Instituti Albanologjik, Prishtinë, 2010, fq.110.

### 3. Katalizatorët letrarë

- Miti, simboli dhe satira si instrumente që zhveshin kamuflimin politik

-Tregimi satiric, *I ringjalluri i penduar* dhe drama, *Beselam pse më flijojnë* përfaqësojnë hipertekste, tekste të ndërtuara mbi bazën e rimarrjes e modifikimit të miteve me natyrë popullore e biblike. Miti definohet si *gramatikë e imagjinatës, një përmbledhje e imazheve naëve simbolike, të cilat e përbëjnë të ashtuquajturën e pavetëdijshme kolektive të njerëzimit*.<sup>16</sup> Në satirën e Qosjes zë vend miti i ringjalljes me burim popullor (besa e Konstandinit) dhe biblik (ringjallja e Jezu Krishtit), i cili vjen këtu përmes një figure pompoze historike, Skënderbeut, për të ndërtuar kontrastin e kohëve, figurave si rrënim i asaj çka shihet si ndërtim i drejtë e progresiv, pra si mit i transformuar në funksion të demaskimit të sistemit “demokratik” arbitrarisht destruktiv.

Ringjallja si arketip i hershëm në letërsinë popullore si glorifikuese e virtytit të shqiptarit-mbajtja e besës e ngritur në nivel sublim që tejkalon edhe vdekjen (vëllai ngritet nga varri për t’i dërguar së ëmës motrën e martuar larg me lejen e premtimin e tij), si arketip biblik që shenjon fuqinë dhe rëndësinë e urdhrit biblik të shpallur nga Zoti (ringjallja e Jezu Krishtit) vendoset brenda një letrarizimi historiko-politik në përmasa groteske ku gjithçka ironizohet me një theks të veçantë përmes të qeshurës së Skënderbeut.

Është e veçantë të shihet në komperacion, forma e ringjalljes së Konstandinit me atë të Skënderbeut, për të parë më në dritë dromcat e para të transformimit:

- *Në mesnatë Kostandini u ngrit nga varri. Guri i varrit u bë kalë i zi si nata edhe dheu i zi u bë shalë e zezë si nata... Trimi i hipi kalit, u përkul përpara uli kryet dhe i ra me shporret. Kaptoi si frymë male e fusha hodhi lumenj e përrenj, la prapa katunde, kodra pyje...*<sup>17</sup>
- *Marr vesh se Skënderbeu është ringjallur në orën e 3 e 33 minuta të mëngjesit të hirtë të 28 nëntorit... Shko i kishte thënë i plotfuqishmi –... dhe në qoftë se pendohesh, kthehu ku ke qenë. Ta kam ringjallur edhe kalin që të mund të kthehesh më shpejt. Të faleminderit, Perëndi, që ma ke ringjallur të vetmen krijesë që më ka mbetur besnike deri në çastin e fundit.*<sup>18</sup>

Përmbajtja e diskursit dhe modelit popullor në të parën, me krahasime e metafora infantile, del tejet e thukët e denotative në raport me sugjestionin përmbajtësor thumbues e kritik me ironinë që përdor autori në pjesën e dytë. Pra, autori qysh në çastet e para të Skënderbeut shfaq indiciet e një trajtimi tematik që synon të kapërthejë probleme universale të funksionimit shoqëroro-politik të shqiptarëve, pra ambientin e konsumuar nga tradhëtarët, hipokritët e demagogët.

Krahas këtij miti që del më tepër në funksionin e demaskimit politik, autori mbindërton dramën e tij *Beselam pse më flijoj* në themelet e mitit të flijimit. Ngjashëm si te Rozafati edhe këtu spikama vihet në tre vëllezër që merren me ndërtimin e urës, prapë është nusja e vogël ajo që flijohet për të ndaluar kështu rrënimin e urës, e cila masivisht del si ideal i masës për çlirim, integrim me tjetrin, botën, dhe është kjo pika prej nga nxjerr krye pasuria ideore që i vesh autori dramës në një nivel universal- inferioriteti i shoqërisë brenda një sistemi totalitar.

Këtu çmitizimi realizohet në dy pika kryesore: si përmbysje e idesë së flijimit si zgjidhje për problemet e njeriut (edhe pas sakrificës së Hanës s’përfundojnë rrënimet) dhe gjithashtu vetë sakrificës si vepër utilitare (Hana flijohet pa dëshirë, madje nën britma e dënësë ku bën lutje që ta lënë të jetojë).

Çmitizimi i tillë i shërben autorit për të përplasur dy psika të ndryshme, komunizmin dhe konservatorizmin, dhe avantazhin e të parës në raport me infantilitetin e së dytës, pra masës që bie pre e sistemit, duke e mbështetur idealin e tij në arketipin e tillë balador, që paradoksalisht

<sup>16</sup> Osman Gashi, *Kufijtë e letërsisë*, Rozafa, Prishtinë, 2008, fq.9.

<sup>17</sup> Mitrush Kuteli, *Tregime të moçme shqiptare*, Berati, Prizren, 2011, fq.25.

<sup>18</sup> Rexhep Qosja, *I ringjalluri i penduar*, Instituti Albanologjik, Prishtinë, 2010, fq.311.

jepet në përmasa sublimë si zbatim funksional i së kaluarës. Në këtë rrugë autori bën objekt të zhvësh një realizim të tillë nga çdo funksion utilitar duke e vendosur përmbysjen e vërtetësisë së këtij arketipi dhe progresivitetin e sistemit në një rend sintagmatik. Pra, është sistemi që bën rrënimet, dhe insistimi i njeriut se procesi i tillë duhet luftuar me flijimin, si ogur i mirë që ndalon rrënimet përbëjnë linjën ku del fytyra e sistemit që shfrytëzon dobësinë e masës, dhe kësaj të fundit që bart konsekuencat e bindjes së saj, çka shënohet me triumfin e totalitarizmit. Parabola e famshme se *libri është i bërë prej shenjash që flasin për të tjerat shenja, të cilat nga ana e vetë flasin për gjërat, kur s'ka një sy që ta lexojë, atëherë shenjat që përmban libri nuk krijojnë koncepte, pra libri mbetet memec*<sup>19</sup> bën fjalë për natyrën aq komunikuese të letërsisë, natyrën shumështrësore të saj. Qosja do shquar pikërisht si një autor i tillë i strukturave komplekse semantike, ku simboli, alegoria e satira, përcaktojnë fatin e tekstit. Në romanin *Një dashuri dhe shtatë faje* është e rëndësishme të vihet theksi në dy tregime të cilat përthekojnë filozofinë e funksionimit të sistemit: *Tregimi simbolik* edhe *Hirmadhja*. Me të parin prezantohet natyra e sistemit të kamufluar, me vallen e shpezëve të shndërruar në një ambient të përgjakur, ndërsa me të dytin frikën dhe nënshtrimin e popullit ndaj një të panjohure të fuqishme. Një ndërtim i veçantë simbolik del edhe brenda tregimit *Fjalori i fshehur*, ku fjalët i nënshtrohen risemantizimeve, që anojnë drejt interpretimit gjithashtu të strukturës molekulare, pikave kyçe prej të cilave ndërtohet ideja e strukturës ideopolitike totalitare.

Vetë personazhet e romanit, etiketimi i tyre përmes një veçorie kryesore, çka edhe është element relevant i natyrës moderne do vështruar në nivel simbolik, si personazhe që *bëhen përfaqësime të koncepteve*.<sup>20</sup> Në këtë sens gjithë tregimet duhen vështruar si modelime simbolike, si ndërtime të tërthorta të situatave klaustrofobike të individit vazhdimisht të persekutuar psikikisht e fizikisht nga pushteti. Kështu për shembull në rrëfimin e Çerem Çaparit, qentë shfaqen si identitete servile të sistemit, pra individë që nuhatin, përndjekin, tërbohen e sulmojnë si qen.

Satira si *zhanër që fitohet duke alternuar diskursin përqeshës me një temë aktuale politike*,<sup>21</sup> përbën kontekstin kryesor letrar në të cilën vendoset subjekti i tregimit *I ringjalluri i penduar*. Gjithçka këtu i nënshtrohet një procedimi përqeshës e thumbimi të ambientit socio-politik të konstruktuar pas luftës së fundit në Kosovë. Vetë kërkesa në thelb fantastike, ringjallja e Skënderbeut vjen si iniciativë e zyrtarëve partiakë, Gojë Burrelit, Muhamet Turjelës, të cilët thuhet të kenë harruar kur kanë hyrë në kishë për herë të fundit që paradoksalisht kur vie fjala për të bërë kompromis me masën, për të triumfuar në zgjedhjet e vendit, vijnë e rrëfohen si shenjëtorë. Për ta Kujtim Rrahmani do të thoshte edhe djalli e citon biblën për nevoja të veta. Skënderbeu në një progresivitet vendoset në situata komike: kur ndalet nga doganierët, të cilët kërkojnë çarmatosjen e tij, kur sheh masën se si imiton politikanin demagog e kur vë në kontrast kohën e tij me atë në të cilën është ringjallur. Kudo ndjehet thumbi i autorit ndaj ndërtimit të sistemit si strukturë e korruptuar e demogje që e ka shndërruar vetë politikën, vizionin progresiv të saj në një opium për popullin.

- Homogjeniteti tematik brenda heterogjenitetit të formës letrare

Identiteti diversiv letrar që Qosja u vesh tri veprave *Një dashuri dhe shtatë faje*, *Beselam, pse më flijojnë?* dhe *I ringjalluri i penduar*, provojnë për autencitetin tematik që autori ruan si pikë konjektive midis tyre duke e zhvilluar brenda kornizave që përcaktojnë konvencionet përkatëse letrare. Romani, drama e satira, përbëjnë kufijtë letrarë prej nga merr hapësirë e shtjellohet tema individi, shoqëria dhe sistemi, relacioni konsekuent i tyre si rrjedhojë e ndjekjeve të idealeve vetjake që cenojnë tjetrin. Kështu sistemi në raport me veten është identiteti i bazuar

<sup>19</sup> Umberto Eco, *Emri i trëndafilut*, Koha ditore, Prishtinë 2005, fq.354.

<sup>20</sup> Ag Apolloni, *Parabola postmoderne*, Bardbooks, Prishtinë, 2019, fq.132.

<sup>21</sup> Po aty, fq.321.

në norma që ka për qëllim ta shtrojë bashkim-vëllazërimin si ide fikse që duhet të ndjekë masa dhe si i tillë sado që fanatik është autentik në mënyrën e vet dhe këtu identiteti tjetër që shpërfaq individualitet brenda një kornize ku kërkohet me këmbëngulje të unanizohet shoqëria, del si cenes i këtij sistemi, provokues i stabilitetit të tij. Parë në një raport invers individi i cili insiston për autencitet e sheh si cenes sistemin e tillë totalitar, pengesë në gjëllimin e tij të lirë. Prandaj edhe ndodh përplasja, të cilën Qosja e jep në rrafshin romanesk, dramatik dhe satirik. Struktura e romanit *Një dashuri dhe shtatë faje*, adresimi i tij si dorëshkrim, ndarja në tregime/kujtime të protagonistit, statusi i tij i dyfishtë, natyra postmoderne me intertekstualitetin, shpërbërjen e fabulës e ironinë, i japin hapësirë autorit që të manovrojë me temën më tepër se në dy të tjerat. Në këtë pikë autori internon modele të ndryshme individësh që e sfidojnë sistemin dhe metodat që zbaton ai ndaj tyre, duke dhënë kështu edhe një tablo më të gjerë të realitetit socio-politik të kohës- kolapsi i komunizmit jugosllav në ballafaqimin me demonstratat studentore, periudhën kohore prej një viti. Gjerësia e romanit bën që brenda strukturës tematike të internohen edhe mikrotëma tjera, të ashtuquajturat motive, të cilat edhe përplotësojnë identitetet që trajton ai.

Tregimi, *I ringjalluri i penduar*, i veshur me statusin satirik, bëhet krijim letrar demaskues i sistemit në një nivel më implicit, pra përmes përqeshjes, thumbimit, paradoksit. Gjithë subjekti kryesor zhvillohet brenda një dite të vetme, Skënderbeu ringjallet, vështrohet i dëshpëruar në mënyrën e funksionimit të vendit nga politikanët demagogë, i penduar vendos të kthehet: *së paku në atë Botë, mendon, secilit i dihet vendi që i takon!*<sup>22</sup> Episodet e tregimit lidhen natyrshëm mes vete duke ndjekur një linearitet suksesiv, çka mungon te romani i Qosjes, kapitujt e të cilit mund të qëndrojnë fare mirë edhe të pavarur.

Drama, *Besëlam pse më flijojnë* nga ana tjetër, realizohet në pesë pamje, të gjitha të rezervuara në dhënien e një portreti universal të sistemit totalitar, gjë që veçse paralajmërohet me përcaktimin e kronotopos të Qosja prezanton në parahyrjen e dramës. Çka del si pjesë më dinamike e dramës e çka është më e rrudhur në strukturat narrative është dialogu, si pjesëmarrës aktiv, krahas aksionit që është më i rrudhur si kundërvënie ndaj romanit e rrëfimit. Drama është hipertekst, pra tekst që ndërtohet mbi modelet baladeske të flijimit, por që realizohet me intencën për t'iu kundërvënë mitit që merr për motiv kryesor. Romani, *Një dashuri dhe shtatë faje*, tregimi satirik, *I ringjalluri i penduar* dhe drama, *Besëlam, pse më flijojnë?* ofrojnë pamjen që ka për model ndërtimin e sistemeve ideopolitike autoritare në raporte të ndryshme letrare të cilat edhe kushtëzojnë vetë formën dhe shtrirjen hapësinore të temës.

Ajo çka del si karakteristike e tekstit qosjan është gërshetimi koherent i pluroelementeve përmbajtësore të cilat i japin një natyrë dinamike tekstit, si internimi i kujesës mitike e historike, ndërthurja e faktit dhe fiksionit e maksimave filozofike. Teksa me romanin Qosja ndërton një ndër tekstet letrare më të rëndësishme postmoderne në letërsinë shqipe, duke dëshmuar me masivitet për aftësi e prirje letrare brenda kësaj rryme, çka edhe bëhet faktor themelor që e aktualizon veprën e tij vazhdimisht, tregimi dhe drama me rimarrjen e miteve dhe subordinimin e tyre brenda konteksteve të piketuara historike bëhen reflektuese të realiteve universale e të trija sëbashku dëshmojnë për interaktivitetin permanent midis individit, shoqërisë dhe sistemit, si struktura ku qenia provon ekzistencën në një masë dinamike.

<sup>22</sup> Rexhep Qosja, *I ringjalluri i penduar*, Instituti Albanologjik, Prishtinë, 2010, fq.361.

## Referencat

- [1]. Rexhep Qosja: *Një dashuri dhe shtatë faje*, Instituti Albanologjik, Prishtinë, 2010.
- [2]. Rexhep Qosja: *Mite të zhveshura*, Instituti Albanologjik, Prishtinë, 2010.
- [3]. Rexhep Qosja: *I ringjalluri i penduar*, Instituti Albanologjik, Prishtinë, 2010.
- [4]. Adil Olluri: *Miti i zhveshur*, në librin “Krijimtaria shkencore dhe letrare e Rexhep Qosjes”, Instituti Albanologjik, Prishtinë, 2007.
- [5]. Ag Apolloni: *Parabola postmoderne*, Bardbooks, Prishtinë, 2019.
- [6]. Ali Aliu: *Kritika*, Rilindja, Prishtinë, 1980.
- [7]. Armagedoni: *Dramat e Qosjes Armagedoni*, Prishtinë, 2019.
- [8]. Linda Hutcheon: *Poetika e postmodernizmit*, Om, Prishtinë, 2013.
- [9]. Mitrush Kuteli: *Tregime të moçme shiqiptare*, Berati, Prizren, 2011.
- [10]. Osman Gashi: *Kufijtë e letërsisë*, Rozafa, Prishtinë, 2008.
- [11]. Resmije Kryeziu: Fjalori në strukturën e romanit *Një dashuri dhe shtatë faje*” në librin *Krijimtaria shkencore dhe letrare e Rexhep Qosjes*, Instituti Albanologjik, Prishtinë, 2007.
- [12]. Umberto Eco: *Emri i trëndafilit*, Koha ditore, Prishtinë 2005.